

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E RAHOVECIT OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	---	---

Për:	Operatori Ekonomik: N.T.P. „Bletaria Egzoni” me adresë në GJAKOVË Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	26.05.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 63 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, sa i përket **Kërkesës për Rishqyrtim** të datës: **26.05.2025**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: **N.T.P. „Bletaria Egzoni”** me adresë në **GJAKOVË**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Furnizim me ushqim për bletë**, me Numër të prokurimit: **623-25-2660-1-2-1**, Numër i brendshëm: **623-25-031-1-2-1**, nxjerr:

VENDIM

- I. **REFUZOHET** e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik: **N.T.P. „Bletaria Egzoni”** me adresë në **GJAKOVË**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Furnizim me ushqim për bletë**, me Numër të prokurimit: **623-25-2660-1-2-1**, Numër i brendshëm: **623-25-031-1-2-1**, kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK-së, të datës: **22.05.2025**, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>
- II. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftim Mbi Vendimin e Autoritet Kontraktues për aktivitetin e prokurimit, me Numër të prokurimit: **623-25-2660-1-2-1**, Numër i brendshëm: **623-25-031-1-2-1**
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

ARSYETIM

Operatori Ekonomik: **N.T.P. „Bletaria Egzoni”** me adresë në **GJAKOVË**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Furnizim me ushqim për bletë**, me Numër të prokurimit: **623-25-2660-1-2-1**, Numër i brendshëm: **623-25-031-1-2-1**, kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK-së, të datës: **22.05.2025**, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **26.05.2025**, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

BAZA LIGJORE PËR REFUZIM TË KËRKESËS

Ju sqarojmë se pretendimet e tua ankimor nuk qëndrojnë dhe janë të pabazuar, pasi që vlerësimi i ofertave është bërë konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik
Autoriteti Kontraktues: Komuna e Rahovecit, ju ka Njoftuar juve si Operator Ekonomik ankues, sipas formularit **B46 Letër standarde për tenderuesin e pasuksesshëm**

Pretendimi Ankimor:

Pas analizës që i kemi bërë dokumenteve të OE të rekomanduar për kontratë kemi ardh në përfundim që OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm për faktet si në vijim:

Në dosje të tenderit përkatësisht tek kapaciteti teknik dhe profesional është kërkuar “*Kërkesa 2: Prezantimi i produkteve të ofruara me katalogë/broshura*”, ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar “*Dëshmia 2: Operatori Ekonomik duhet të paraqesë tek AK katalogë/broshura nga prodhuesi i këtyre furnizimeve për produkte të ofruar duke e nënvizuar produktin e ofruar, së bashku me një përshkrim të karakteristikave të produkteve siç kërkohet në specifikimet teknike*”.

OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson kërkesën e lartcekur për faktin se në dosje të tenderit, kërkesa ka qenë e specifikuar saktë që katalogu apo broshura duhet të ofrohet nga

prodhuesi. I njëjti përveç se nuk ka prezantuar katalog, sepse kinse katalogu i prezantuar nga i njëjti nuk mund të quhet as katalog, por është vetëm deklaratë për specifika teknike.

Përgjigje në Pretendimin Ankimor:

Ju sqarojmë se lidhur me pretendimin tuaj ankimor, për Operatorin Ekonomik të rekomanduar për kontratë është i pabazuar

Sipas nenit 59 paragrafi 4 i LPP-ës, Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në Njoftimin e Kontratës dhe në Dosjen e Tenderit

Operatori Ekonomik i propozuar për Kontratë, përpos Katalogut të prezantuar dhe të përshkruar në katalogë/broshura të gjitha artikujt në bazë Specifikimeve teknike të kërkuara në Dosjen e Tenderit, i njëjti ka ofruar edhe Deklaratë me shkrim se do t’i përmbahet në përgjithësi specifikimeve teknike të detyrueshme të paraqitura në Aneksin 1 të Dosjes së Tenderit;

Pretendimi Ankimor:

Njëkohësisht katalogu është dashur të prezantohet nga prodhuesi **sepse në Kosovë nuk ekzistojnë kompani të cilat prodhojnë produktet e kërkuara nga ana e AK-së.** OE i rekomanduar për kontratë nuk është prodhues, andaj përderisa nuk e ka prezantuar katalogun nga prodhuesi, i njëjti është dashur të eliminohet dhe jo të rekomandohet për kontratë.

Përgjigje në Pretendimin Ankimor:

Në ofertën e juaj të dorëzuar, nga ana juaj si Operator Ekonomik Ankues, keni prezantuar Catalog me Kompaninë: **RADOMED szr, Leskovac nga Srbija;**



Përpos kësaj katalogë me kompani nga Serbia nuk lejohen që të shfrytëzohen në Kosovë, për shkak të sigurisë së të RrUOPP dhënave ashtu siç e përcakton neni 19.8 i cili thotë: *Për aplikim të paragrafit 19.7 Autoritetet Kontraktuese duhet të sigurohen që pajisjet, shërbimet dhe prodhuesit e specifikuar nuk i takojnë vendeve (shteteve) për të cilat Qeveria e Kosovës ka vendosur sanksione në import/eksport, ose vendeve, prodhimet, shërbimet dhe furnizimet e të cilave konsiderohen si të pabesueshme nga ndonjëra prej organizatave/vendeve, siç janë: Bashkimi Evropian, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, NATO, OECD ose Shoqata Evropiane për Tregti të Lirë;*

Pretendimi juaj në këtë pikë është i pabazuara

Nga konstatimet e lartcekur u vendos si në dispozitave të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi të AK-së ju munde të paraqitni ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>